

ZOTAT E ZINJ - ZOTAT E RREMË TË EGJIPTIT TË LASHTË

Marrë nga: www.salafimanhaj.com

Egjipti i lashtë njihet si një ndër civilizimet më të vjetra të botës dhe shteti më i organizuar, me rendin shoqëror më të përparuar të kohës. Egjipti i lashtë ishte shteti më i madh politik në botë i kohës së tij dhe shteti më i madh unik në tremijë vitet e ekzistencës së tij. Aftësitë e tyre të shkrimit, që janë zbuluar rreth mileniumit të 3-të p.e.r.¹ dhe përfitimet që kishin nxjerr nga lumi Nil kontribuan që vendi i tyre natyror të mbrohej prej sulmeve të huaja. Struktura qeverisëse dhe sektori masiv shtypës ishin nën masat e kontrollit rigoroz të shtetit dhe ideologjisë së tij. Por, në këtë “shoqëri të civilizuar” sundonin Faraonët, mosbesimi i të cilëve vazhdimisht theksohet në Kur’an. Faraonët me arrogancën, mendjemadhësinë dhe krenarinë e tyre (për të cilat autorët afro-centrikë pohojnë të kenë qenë “krenaria e zezakëve”) bënë që e tërë infrastruktura e tyre shoqërore, politike, ushtarake dhe fetare të shkatërrohej. Asgjë nuk u ndihmoi atyre për ta ruajtur civilizimin dhe përparimin e as besimet e tyre politeiste mbizotëruese. Një numër i madh njerëzish ishin angazhuar në projektin shtetëror për ngritjen e përmendoreve mbi varre, tempujve, piramidave dhe fortesave, të gjitha këto në kuadër të monumenteve shtetërore. Allahu thotë në Kur’an:

“Me të vërtetë që Faraoni madhështohej në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtet keqbërës.” (Kur’an, 28:4).

Një ndër autorët afro-centrikë më ekstrem ishte John Henrik Clarke. Ai pohonte se Profeti Musa (Moisiu), paqja qoftë mbi të, ishte një semit i bezdisshëm, i cili me të drejtë ishte dëbuar prej Egjiptit nga Faraoni, një nacionalist afrikan?!² Clarke, po ashtu, e kishte përshkruar Muhamedin, salallahu alejhi ue selem, si abuzues fëmijësh.³

Edhe autorët tjerë afro-centrikë përkrahnin mendimet e Clarke, mirëpo të tillët duhet ta dinë se, nëse pretendojnë të jenë “nacionalistë afrikanë”, duhet ta kenë parasysh faktin se martesat me vajza të reja janë tejet të përhapura dhe pjesë e shumë kulturave të kontinentit afrikan. Nuk dihet nëse Henrik Clarke është penduar prej urrejtjes që kishte ndaj Profetëve dhe të Dërguarve të Allahut para se të vdiste, se përndryshe ka shumë gjasa që ai t’i nënshtrohet dënimit të rëndë në varr. Allahu në Kur’an tregon për gjendjen e atyre që përqeshnin dhe talleshin me Profetët dhe të Dërguarit e Tij:

¹ Para erës së re.

² John Henrik Clarke “African World Revolution- Africans at the Crossroads” (Revolucioni botëror afrikan - afrikanët në udhëkryq), (AWP: 1991) fq. 354.

³ Referoju *‘Eid Khutbah* “Love of this Life” (Dashuria e kësaj jete) nga Daawood Adeb.

“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të dërguar para teje, por ata që përqeshnin i përfshiu ajo me të cilën ata talleshin. Thuaj: “Udhëtoni nëpër botë e shihni çfarë dënimi kanë marrë ata që përgënjeshtrojnë (të dërguarit).” (Kur’an, 6:10-11)

“Ne i çojmë të dërguarit vetëm si përcjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues. Por mohuesit (e besimit) polemizojnë me argumente të rreme për ta dobësuar të Vërtetën, ndërsa shenjat dhe paralajmërimet e Mia i marrin për tallje.” (Kur’an, 18:56)

“Eh, sa profetë u dërguam Ne breznive të mëparshme, por, sa herë që u vinte atyre ndonjë profet, ata talleshin me të!” (Kur’an, 43:6-7).

Pretendimet e Henrik Clarke dhe përkrahësve të tij janë shembull i pikëpamjeve ekstremiste, që shfaqin autoritet afro-centrikë vetëm e vetëm për ta lavdëruar Egjiptin e lashtë dhe strukturat e përsosura të pushtetit të tij. Këta njerëz përherë shprehin lëndat e tyre të zjarra për Egjiptin e lashtë si “triumf i pushtetit të zi” dhe model që ende duhet ndjekur!

Në librin ku shtjellohet në imtësi mënyra se si Profetët dhe të Dërguarit bënë thirrje për tu adhuruar vetëm Allahu, dijetari musliman bashkëkohor Shejh Rebi Ibn Hadi el-Med’hali⁴ thekson këtë:

“E vërejmë se Profeti Musa thërriste në Teuhid⁵, duke bartur dritën e udhëzimit dhe urtësisë. Musa ishte rritur dhe edukuar në pallatet e tiranit më të madh që e kishte shpallur veten e tij hyjni. Musa ishte në njohuri për shumë lloje të çoroditjeve, mosbesimit, tiranisë, padrejtësisë e despotizmit, ngase që dëshmitar i tyre në pallate. Aty kishte parë gjëra që vështirë se mendja mund t’i përfytyrojë. Kishte parë robërimin e popullit të tij, Bijve të Izraelit, poshtërimin e tyre, robërimin e grave dhe shfarosjen e fëmijëve të tyre, deri në atë shkallë, sa ia tejkalonte çdo tiranie që njihete njerëzimi.”⁶

Allahu thotë në Kur’an:

⁴ Ai është Shejh Rebi Ibn Hadi el-Med’hali el-Kahtani. U lind në vitin 1352 p.h. Ish kreu i Departamentit për Studime të Larta në Sunetin Profetik në Universitetin e Medinës. Ish mësuesit e tij ishin Shejh Abdul-Aziz Ibn Abdullah Ibn Baazi, Shejh Nasirudin el-Albani, Shejh Abdul-Muhsin el-Abad, el-Hafidh el-Hakimi, Shejh Abdul-Gafar Hasen el-Hindi, dhe Shejh Muhamed Amin el-Xhenki esh-Shankiti.

⁵ Teuhid është monoteizmi në Islam, që nënkupton fokusimin e adhurimit vetëm për Zotin, Një dhe të Vetëm (Allahun) dhe dëshmia se vetëm Allahu ka të drejtë të adhurohet.

⁶ Shejh Rebi Ibn Hadi el-Med’hali “The Methodology of the Prophets in Calling to Allah - That is the way of Wisdom and Intelligence” (Metodologjia e Profetëve në thirrjen tek Allahu- Kjo është rruga e urtësisë dhe mençurisë) përktheu nga arabishtja në anglisht Ebu Talhah Daawood Ibn Ronald Burbank (al-Hidaayah Publishing: 1997) fq.98.

“Me të vërtetë që Faraoni madhështohej në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtet keqbërës.” (Kur’an, 28:4).

Mania perëndimore për Egjiptin buron nga ideja se ky vend është mbetja e fundit e “shtatë mrekullive të botës”, koncept evropian që i ka dhënë Egjiptit të lashtë një status edhe më të lartë “mistik”. Raftet e shumë librarive, që gjenden buzë rrugëve kryesore, janë të mbushura me koleksione të literaturës e cila synon “dekodimin e kodeve hieroglifë”, “zgjdhjen e mistereve të fshehta” dhe “gërmimin brenda kuptimeve” të magjistarëve të Egjiptit të lashtë! Këto teori të pazakonshme marrin për bazë atë që quhet New Age (filozofi që lind në fund të viteve 1980, e cila karakterizohet me një tërësi besimesh në spiritualizëm, astrologji, mjekësi alternative, etj. Shih: <http://encyclopedia2.thefreedictionary.com/new+age> –sh.p.) dhe teologjinë okultiste. Për shembull, autorët satanist si Aleister Crowley përherë ngrehin në qiell religjionin dhe magjitë e Egjiptit të lashtë, duke e parë këtë si plan të shejtanit⁷. Crowley në librin e tij “The New Law of Man” (Ligji i ri i njeriut) deklaroi se kodi i ligjit të tij satanist do ta zëvendësojë Kur’anin, ligjin më universal për njerëzimin.

“Musai u tha atyre: “Të mjerët ju! Mos trilloni gënjeshtër për Allahun, duke bërë që Ai t’ju shkatërrojë me dënim. Do të dështojnë, me siguri, ata që trillojnë gënjeshtër!” (Kur’an, 20:61)

Njëri ndër të parët që u morr me Egjiptin e lashtë për “udhëzim hyjnor” ishte Charles Piazzi Smyth.⁸ Idetë e tij joshën afro-centrikët tjerë siç është John G. Jackson, i cili po ashtu ishte shumë i dhënë pas ideve okultiste të egjiptianëve të lashtë.⁹ Një tjetër autor që ngashënjeu afro-centrikët e hershëm ekstremë ishte John Taylor, i cili shkroi diku në vitin 1859¹⁰. Një gjë dihet, i ashtuquajtur “mendim afro-centrik” nuk është i rrënjësor në

⁷ Kjo temë ka zgjuar kërkuesit tek shumë muslimanë, por në përgjithësi dijetarët islamikë nuk u rekomandojnë muslimanëve të rëndomtë, që kanë njohuri mesatare për fenë Islame, të hyjnë në detaje të kësaj teme. Shumë muslimanë kanë rënë në gabime kur janë futur në këtë lëmi. Për shembull, David Moosa Pidcock nga Partia Islame e Britanisë së Madhe, parti moderniste, është autor i “Satanic Voices - Ancient and Modern” (Zërat satanike - të lashtë e modern), (Mustaqim Islamic Art and Literature Publishers: 1412 p.h./ 1992 e.r.). Pidcock ka zbuluar një lloj të teorive konspirative, kodeve masonike, etj! Disa nga këto tema janë të rëndësishme, por nuk ka nevojë që Pidcock të udhëtojë në tërë Mbretërinë e Bashkuar për t’iu ligjëruar muslimanëve të thjeshtë këso lloj temash, kur dihet se shumë muslimanë nuk kanë njohuri të qarta për kredon e tyre të trashëguar nga brezat e mëhershëm të muslimanëve.

⁸ Leonard Cottrell “The Great Pyramids” (Piramidat e mëdha), në kapitullin “The Mountains of the Pharaoh” (Malet e Faraonit), (Londër: 1995).

⁹ Shih hyrjen e Jacksonit të “African Civilization” (Civilizimi afrikan), origjinali i botuar në vitin 1970 dhe përsëri në vitin 1994. Thënë me ironi, Jackson ishte anëtarë i “Rationalist Press Association” (Shoqata e gazetarëve racionalist) të Londrës, por pasonte koncepte joracionale!

¹⁰ Stephen Howe “Afrocentrism-Mythical Pasts and Imagined Homes” (Afrocentrizmi - Të kaluarat mitike dhe vendlindjet e imagjinuara), (Londër dhe New York: Verso, 1998) fq. 122.

idetë, punimet apo studimet e afrikanëve, por në ato të evropianëve! Në të kaluarën, autorët afro-centrikë organizonin udhëtime turistike në Egjiptin e faraonëve. Këto udhëtime udhëhiqeshin nga ciceronët afro-centrikë Joseph Ben-Jochannon, Henrik Clarke, Karenga, Leonard Jeffries.¹¹ Autori bashkëkohor afro-centrik, Anthony T. Browder, kreu i institutit të errët “Institute of Karmic Guidance” (Instituti për udhëzime karmike) kishte publikuar një libër me titull “My first trip to Africa” (Udhëtimi im i parë në Afrikë) (Washington, 1991), ku promovonte dhe reklamonte “udhëtimet e tilla” dhe pelegrinazhet tek piramidat. E vërteta është se Egjipti i lashtë kishte pasur shumë të meta. E meta më e madhe ishte se sunduesit e këtij shteti pretendonin të jenë Krijues i qiejve dhe tokës. Allahu na e përkujton këtë në Kur’an:

“Por ai (Faraoni) e mohoi dhe e kundërshtoi. Pastaj i ktheu shpinën, duke u përpjekur (kundër së vërtetës) dhe tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!” Prandaj Allahu e goditi atë me dënim në jetën tjetër dhe në këtë jetë. Kjo është këshillë për ata që i frikësohen Allahut.” (Kur’an, 79:21-26).

Një pretendim tjetër i afro-centrikëve është ai se ligjet që iu shpallën Musës, paqja qoftë mbi të, në të vërtetë, janë marrë nga punimi ezoterik i Egjiptit të lashtë “The Osirian Drama”!¹² (Drama Osiriane [Osiris ishte perëndia e lashtë egjiptiane e nëntokës, vdekja dhe ringjallja vjetore e së cilës personifikohej në vetëngjalljen, vitalitetin dhe pjellorinë e natyrës. Shih <http://www.thefreedictionary.com/osirian-sh.p>]). Autorët tjerë afro-centrikë, siç është Yosef Ben-Jochanon, pohonin se ligjet e Musës kanë prejardhje nga “Negative Confessions” (Konfesionet negative), që është gjetur në varrin e Ramzes-it të gjashtë!¹³ Një autor tjetër afro-centrik, Meulana Karenga, thotë se ligjet e Profetit Musa, paqja qoftë mbi të, janë nxjerrë nga kapitulli i 125-të i librit “Book of Coming Forth by Day” (Libri i së nesërme).¹⁴

Këto ide të pakapshme paraqesin pikëpamjet më ekstreme që mbështetën nga autorët afro-centrikë. Shumë shkencëtarë kanë vërejtur se këto “ligje” të Egjiptit të lashtë nuk përkrijnë aspak me ligjet e Musës.¹⁵ Veç kësaj, këto libra të lashta egjiptiane të idhujtarisë përmbajnë “formula magjike”, dokrra e marrëzi tjera. Atëherë, si është e mundur që Profeti i Zotit, Musa, paqja qoftë mbi të, të ketë marrë dituri nga këto libra?! Për më tepër, është e njohur se urdhri kryesor i Musës ishte të adhurohej vetëm Allahu dhe të mos vizatohej ndonjë imazh i Zotit për adhurime. Dihet se egjiptianët e lashtë kishin shkuar kundër këtyre urdhrave, duke bërë lloj-lloj imazhesh të gjallesave, siç janë qentë,

¹¹ Ibid, fq. 124.

¹² Akyaabaa Addai-Sebo dhe Ansel Wong (redaktorët) “Our Story- A Handbook of African History and Contemporary Issues” (Tregimi ynë - Doracak i historisë afrikane dhe çështjeve bashkëkohore), (Londër:1998) fq.15.

¹³ ibid, fq.130.

¹⁴ ibid, fq. 213.

¹⁵ Stephen Howe “Afrocentrism - Mythical Past and Imagined Homes” (Afrocentrizmi - Të kaluarat mitike dhe vendlindjet e imagjinuara), fq. 127.

macet, madje edhe imazhe të penisit! Hargreave Jennings në librin e tij “Phallicism - Celestial and Terrestrial, Heathen and Christian and its Connection with the Rosicrucians and the Gnostics” (Fallicizmi¹⁶ qiellor dhe tokësor, pagan e i krishterë, dhe lidhja e tij me Rendin e Kryqit Bojë Rozë dhe me gnostikën) shprehet kështu:

“Te egjiptianët e lashtë, obelisku dhe piramidat, si objekte të rëndësishme, shiheshin si dy fuqi të kundërta në botë, të cilat vepronin dhe reagonin përjetësisht ndaj njëra tjetrës ... obelisku konsiderohej si organ gjenital mashkullor, ndërsa piramida si organ përkatës i fryre femëror”¹⁷

Peter Thompkins në “The Magic of the Obelisks” (Magjitë e obeliskëve)¹⁸ citon masonin R.T. Rundle të ketë thënë se imazhi i penisit të zotit të rremë të Egjiptit të lashtë *Ra-Atum* simbolizonte një obelisk. Vallë, autorët afro-centrikë dëshirojnë t’i kthejnë njerëzit, apo vetëm zezakët, në adhurim të penisit?!

Çështja tjetër me të cilën janë preokupuar autorët afro-centrikë është ajo e racës së Egjiptianëve të lashtë. Ndonëse dëshmitë tregojnë se shumë mbretëri të lashta ishin të përziera - kryesisht me popullatë afrikane -, kjo gjë nuk shihet aspak me sy të mirë, për shkak se këta mbretëri i konsideronin vetët e tyre si zota që duhej adhuroheshin. Mu kjo që shkak për shkatërrimin e tyre, duke lënë pas vetes prej fesë dhe mënyrës së jetesës së tyre vetëm ca mbeturina të cilat po orvaten t’i ngjallin afro-centrikët, masonët dhe okultistët.

Allahu thotë në Kur’an:

“Ne i dhamë dhuntinë Tonë Musait dhe Harunit, dhe i shpëtuam ata të dy dhe popullin e tyre nga mjerimi i madh. Ne i ndihmuam dhe ata ngadhënjyen.”
(Kur’an, 37:114-116).

Besimet e arabëve në periudhën para-islamike hedhin dritë mbi një fakt tjetër relevant nga historia e Islamit, që lidhet me këtë idhujtari të “zotit të zi”. Idhulli *el-Uzzaa*¹⁹ adhurohej nga fisi arab Ghatfan. Ky idhull adhurohej në formë të pemës akacie, e rrethuar me faltore nga palmat që rriten mes Ta’ifit dhe Mekës. Kurejshët arabë e përnderonin këtë pemë. Dijetari islamik en-Nesa’i²⁰, Allahu e mëshiroftë, në komentin e

¹⁶ Adhurimi i parimit regjenerues, i simbolizuar nga penisi.

¹⁷ Hargreave Jennings “Phallicism - Celestial and Terrestrial, Heathen and Christian and its Connection with the Rosicrucians and the Gnostics” (Fallicizmi¹⁷ qiellor dhe tokësor, pagan e i krishterë, dhe lidhja e tij me Rendin e Kryqit Bojë Rozë dhe me gnostikën), (Londër: 1884) fq.73.

¹⁸ New York: Harper and Row Publishers.

¹⁹ Disa kanë thënë se ky idhull ka prejardhje nga perënditë e lashta egjiptiane Isis ose Venus të Greqisë së lashtë.

²⁰ Ebu Abdur-Rahman Ahmed ibn Shu’ejb en-Nesa’i. U lind diku në vitin 214 p.h./830 e.r. në qytetin Nesa’a të Horasanit. Pas arsimimit të tij të hershëm në vendlindje, udhëton në Belk, kur ishte vetëm

tij të Kur'anit thotë se, kur Profeti Muhamed, salallahu alejhi ue selem, morri nën kontroll Mekën me shokët e tij, dërgoi Halid ibn Velidin, Allahu qoftë i kënaqur me të, tek faltorja e *el-Uzzaa*-së. Halidi kishte vërejtur se kjo faltore ishte rrethuar me tri pemë, me ç' rast i preu ato dhe rrënoi faltoren. Më pas u kthye tek Muhamedi dhe i tregoi se çfarë kishte bërë, mirëpo Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, i tha: "Kthehu edhe njëherë, sepse asgjë nuk ke bërë!" Halidi kthehet përsëri në vendin e mëhershëm dhe vëren se rojet e idhullit ia kishin mbathur me të katërtat në drejtim të kodrave duke thirrur: "O Uzzaa!", kurse brenda faltores has në një zezake të zhveshur dhe me flokë të shprishura, që hidhte pluhur ne flokët e saj. Halidi e godet atë me shpatë dhe e vret, e më pas kthehet te Muhamedi, salallahu alejhi ue selem. Profeti Muhamed, salallahu alejhi ue selem, i thotë: "Ajo ishte el-Uzzaa." Këtë ngjarje e shënon edhe dijetari tjetër islamik el-Kadi Ijad ibn Musa el-Jehsubi në librin e tij *Kitaab esh-Shifa'*.²¹

Përktheu nga anglishtja: Visar ZEKA

pesëmbëdhjetë vjeçar, për të studiuar hadithin te Kutejbe ibn Sa'id për një vit. Më pas, udhëtimet e tij me qëllim të studimit të hadithit nuk patën të ndalur, derisa vendoset përfundimisht në Egjipt. Ishte një ndër dijetarët më të spikatur të hadithit, *Sunenin* e të cilit muslimanët e konsiderojnë si një ndër gjashtë koleksionet më autetnike të traditës profetike. Vdiq në Damask në vitin 303 p.h./915.e.r.

²¹ Përktheu nga arabishtja në anglisht Aisha Bewley "Muhammad- Messenger of Allah (Ash- Shifa of al-Qadi Iyad)" (Muhamedi- I Dërguari I Allahut [Esh-Shifa e el-Kadi Ijadit]), Kuala Lumpur: Islamic Book Trust, 1997, fq.202.